




Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-40317 dt. 12-07 2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.06.2019

Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiçi, Burim Bujupi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së K.P.F-ca të datës 22.05.2019
2. Propozim-Rregullore komunale për transparencë.
3. Propozim vendim për financimin për projektin KH "Drenica"
4. Propozim vendim për financimin për projektin KF "Feronikeli"
5. Propozim vendim për financimin për projektin KF "Drenasi"
6. Propozim vendim për financimin për projektin Këshillit për veprim Rinor Lokal në Drenas.
7. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022
8. Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ish-in, Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, përfaqesues të OSCE-së si dhe drejtor të drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj: pasi përshëndeti të pranishmit kërkoj nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa se a pajtohen më këtë rend dite apo keni ndonjë propozim, dhe njoftoi se kemi edhe raportin e performances komunale.

Burim Bujupi- sa l përket kësaj pike pasi e mora materialin e shikova se është edhe një pikë shtesë, nëse nuk është shumë me rëndësi me lënë për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- meqë është raport dhe nuk do të votohet vetëm ka me pas për diskutim kisha kërkuar që të jetë këtë mbledhje kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hodhi në votim rendin e ditës, të pranishëm ish-in 7 anëtar: ***Për votuan 07, Kundër 00, abstenim 00.***

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1.Procesverbali i mbledhjes së K.P.F-ca të datës 22.05.2019**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje, apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ish-in 7 anëtar:
Për votuan 07, Kundër 00, Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj-hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim–Rregullore komunale për transparencë.**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje, apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ish-in 7 anëtar:
Për votuan 07, Kundër 00, Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3.Propozim vendim për financimin për projektin KH “Drenica”

Burim Bujupi- dua të flas për të gjitha këto propozim vendime në përgjithësi ndoshta më mirë kishe me qenë më marr një sqarim nga drejtoresha se në çfarë forme ka shkuar kjo ndarje e subvencioneve, cili kriter është përdor, unë i kam shikuar anëtarët e komisionit mirëpo për mua është shumë e pakapshme se diku prej vlerës 57 mijë euro vetëm një klub është i financuar afërsisht 70% të subvencioneve duke e ditur se për klubin e njëjtë si po behet fjalë ka donatore më të mëdha të komunës sonë, kështu që ai klub nuk ka shumë nevojë për subvencione, kërkoj sqarim nga drejtoresha.

Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport, Shqipe Zogu- fillimisht po iu informoj se procedura e ndarjes se subvencioneve ka shku në bazë të rregullores lokale që e kemi pas, pastaj me propozim të nivelit qendror ne jemi detyruar ta anulojmë atë thirrje publike të OJQ-ve për shkak ka pas diskrepanc me rregulloren e nivelit qendror, dhe ne jemi vonuar në kohë, fillimisht ju njoftoi se 57 mijë euro që kanë qenë shuma maksimale e subvencioneve përmes thirrjes publike 42,000 kanë qenë të dedikuara për kulturë, 50,300 për sport dhe 3,000 euro për rini, kjo rregullore i ka specifiku edhe kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të këtyre OJQ-ve meqë njëra ndër kriteret themelore kanë qenë që të gjitha aplikacionet të dorëzohen në zarf të mbyllur dhe hapja e tyre behet vetëm nga komisioni vlerësues, meqë rast unë si drejtoresh por edhe stafi nuk kemi pas qasje në dokumentacione, ka qenë kriter 100% i transparencës, dhe është shqyrtuar vetme nga organi legjitim për shqyrtimin e atyre aplikacioneve, ajo që dua ta theksoj është që të gjithë aplikuesit kanë përfituar nga subvencionet madje me përjashtim të një përfituesi ka rritje të përfitimit në subvencion nga viti i kaluar, secili përfitues ka rritje të subvencioneve nga viti i kaluar. Ajo dua që dua ta theksoj komisioni vlerësues i ka marr për bazë të gjitha kriteret në bazë të kësaj rregulloreje dhe ka zbatuar këtë rregullore. E gjithë procedura ka shku pa asnjë ankesë dhe me dispozita ligjore.

Florentina Elezi- sa i përket këtyre ndarjeve, duhet me pas suport pak më madh nga komuna, për me pas klubet të cilat janë duke shku mirë dhe jo me një shumë kaq qesharake, e shikova peshkatarët e kishin refuzuar atë shumë 300 euro e cila është një shumë qesharake përderisa "Feronikeli" i ka marrë 70% të subvencioneve e ndersa klubet tjera me u nënqmu kaq shumë më duket

qesharake. Unë prap nuk pajtohem me këtë ndarje dhe jam kundër të gjitha këtyre ndarjeve të subvencioneve.

Drejtore she për Kulturë Rini dhe Sport, Shqipe Zogu – unë kam prit që të reagoni pse në sport kanë shkuar kaq shumë mjete dhe pse nuk kanë shkuar në kulture dhe në sferat e tjera për shkak se edhe ato në komunën tonë janë në mungesë të financimit mirëpo për përfituesin që e përmende në bazë të asaj që kam shikuar shoqata e peshkatarëve as nuk ka aplikuar fare për subvencione.

Burim Bujupi, KF "Drenasi" ka qenë ligen e dytë, është bërë kampion në ligën e parë meqenëse po flasim për kampion duhet të përkrahet më shumë, në qoftë se e marrim krahasimin ndër vite, në vitin 2017 subvencione i ka pas 5,000 Euro, dhe është i vetmi klub që e merr shumën 2,500 mijë euro, unë nuk jam kundër pse ju kanë ndarë KF "Feronikelit" kaq shumë por pse disa klube po diskriminohen?

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 03 anëtar, kundër 04, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4.Propozim vendim për financimin për projektin KF "Feronikeli"**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje, apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 03, Kundër 04, Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5.Propozim vendim për financimin për projektin KF "Drenasi"**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje, apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 03, Kundër 04, Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6.Propozim vendim për financimin për projektin Këshillit për veprim Rinor Lokal në Drenas.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje, apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 03, Kundër 00, Abstenim 04.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës. **7. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022.**

Edolina Plakiqi, sa i përket draft kornizës buxhetore nuk është mirë me mbajt ne, në K.P.F pa u mbajt dëgjimi publik me qytetarë, ne e dimë që nesër është dëgjimi publik me qytetar siç e kanë caktuar me 21.06.2019 është më mirë me mbet për muajin tjetër, mos me shku në Kuvend sepse pa u mbajt dëgjimi publik me qytetar ne nuk kemi çka diskutojmë ne.

Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku- sa i përket dëgjimit me qytetar është proces që shkon sipas ligjit, kur te vjen shuma e investimeve kapitale është një shumë të cilën duhet ta orientojmë sipas kërkesave edhe drejtorive edhe qytetareve, sepse drejtoritë i kanë bere kërkesat fillestare. Buxheti i parapamë është i ndarë të tre sektorë: sektori i përgjithshëm apo i administratës, sektori i arsimit dhe sektori i shëndetësisë. Buxheti parapamë i sektorit të përgjithshëm është 7,351,000 Euro, sektori i arsimit është më 1, 152,000 Euro dhe sektori i shëndetësisë është me 1.986.376 euro këto janë edhe kriteret që e përcaktojnë kufijtë buxhetor.

Florentina Elezi, e falënderoj drejtorin për sqarimin dhe dokumenti është shumë mirë i përpiluar, më pëlqen kjo sidomos kabinete nëpër shkolla, për kimi fizikë, dhe biologji. Unë pajtohem që me shku ne kuvend kjo se përndryshe behet vonë për afate ligjor.

Fitore Morina- edhe unë pajtohem që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 07 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **9. Raporti për transparencë komunale të vitit 2018 .**

Pasi nuk pati diskutime të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan të shkojnë në këtë pikë në kuvend.


Kryesuesi i Kuvendit, z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Të ndryshme.**

Edolina Plakiqi- pasi që është qendra familjare në Komoran por mangësia e saj është që nuk kemi shofer të ndihmës së shpejtë, është dashtë me të bëjë një zgjidhje për shofer të ambulantes deri tani?

Flamur Curri- asnjëherë nuk kemi pas me shumë autoambulanca se këtë vit, mirëpo është QMF-ja ajo që i sistemon edhe ata shofer që janë të punësuar në Drenas i bien që janë të punësuar edhe në QMF në Komoran, besoj që do të zgjidhet se shpejtë ai problem.

Pasi nuk pati diskutime tjera mbledhja përfundoi në ora 11:05 min

Procesmbajtëse:



Zahrie Podrimqaku-Subashi



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit



Labinot Halilaj